

DAIM ILAZI

**FIGURA MARKANTE
TE ARBËRESHËT E ZARËS**



DAIM ILAZI-FIGURA MARKANTE TE ARBËRESHËT E ZARËS

DAIMILAZI

FIGURAMARKANTETEARBËRESHËTEZARËS

TETOVË, 2024

DAIM ILAZI-FIGURA MARKANTE TE ARBËRESHËT E ZARËS

Botues: DAIM ILAZI
Redaktor: Rami Kamberi
Resenzent: Dr. Prof. Ejup Ajdini
Lektore: Behare Neziri
Shtypi: Art Grafik–Tetovë
Tirazhi: 200

CIP - Каталогизација во публикација Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје
929(=18:497.581.1)
ILAZI, Daim
Figura markante te arbëreshët e zarës / Daim Ilazi. - Tetovë : D. Ilazi, 2024 (Tetovë : Art Grafik). - 120 стр. : фотографии ; 24 см
Белешка за авторот: стр. 119-122
ISBN 978-608-66366-4-7



Botimin e librit financiarisht e ndihmoi Ministria e
Kulturës së Republikës Veriore të Maqedonisë
Книгата е финансирана од Министерството за Култура на
Република Северна Македонија

Në vend të hyrjes

Arbëreshët (në dialektin arbërisht të gjuhës shqipe: *Arbëneshtë*), janë njohur edhe si arbanasit (kroatisht: *Arbanasi*), janë një bashkësi me prejardhje shqiptare në trevën e Zarës së Kroacisë, që flasin dialektin arbërisht të gegërishtes.

Emërimi *Arbanasë* shtë dhe toponimi i vendbanimit të parë arbëresh në rajon, që sot është periferi e Zarës.

Përveç arbëreshëve në Kroaci jetojnë edhe shqiptarë që mërguan atje në kohën moderne si punëtorë sezonalë, refugjatë lufte ose sportistë, kryesisht nga trevat shqiptarë nën ish-Jugosllavi.

Sot, bashkësia e arbëreshëve është e shpërndarë nëpër Kroaci. Vendbanimet e tyre të para ishin Arbanasi i Zarës dhe disa fshatra rreth Zarës, përkatësisht Zemunik, Dračevac, Crno, Ploča, etj. Fshati Arbanas e morri emrin nga themeluesit e tij, shqiptarët. Arbëreshët dihet se janë vendosur në këto zona gjatë dy periudhave të ndryshme të mërgimeve; e para në vitin 1655 dhe e dyta në votet 1726–1733.

DAIM ILAZI-FIGURA MARKANTE TE ARBËRESHËT E ZARËS

Këta banorë thuhej se ishin pjesë e fisit të Kastriotëve, një nga fiset e shumta të shqiptarëve të veriut. Origjina e arbëreshëve të Zarës është nga treva e Krajës, gjegjësisht nga fshatrat:

- Brisk,
- Shestan,
- Ljare,dhe
- Podë.

Sot pjesë e Komunës së Tivarit në Malin e Zi. Si pasojë e pushtimit osman të trevave shqiptare, kjo popullsi mërgoi në atë që sot është Kroacinë dy periudha të ndryshme: e para në vitin 1655 për në Pullë, Istër^l dhe e dyta në vitet 1726–27 dhe 1733, për në trevën e Zarës, kjo e fundit e planifikuar dhe mbështetur nga kryepeshkopi i Zarës Vicko Zmajević dhe Republika e Venedikut.

Emërimi nga ana e popullsisë kroate për arbëreshët e Zarës është *Arbanasi* (Арбанаси), që është një etnonim i vjetër

DAIM ILAZI-FIGURA MARKANTE TE ARBËRESHËT E ZARËS

që sllavët e jugut e përdornin për shqiptarët, e që daton nga mesjeta.

Figura te ndritura të Zarës

Arbëreshët në Kroaci janë me prejardhje shqiptare të besimit fetar katolik. Vendbanimi i parë i Arbëreshëve të Zarës u themelua në vitin 1726. Shumica e banorëve të Arbanasit janë pasardhës të shqiptarëve katolikë nga zona e Shkodrës dhe Tivarit, të emigruar në vitet 1726, 1727 dhe 1733. Kryepeshkopi i Zarës Vicko Zmajeviq u ka ndihmuar, i priti me zemërgjerësi dhe organizoi jetën e tyre në ambientin e ri. Arbëreshët në fillim morën pjesën më të madhe të tokës në zonën e Zemunikut, ku u vendosën përgjithmonë, si dhe në Murvicë, Rashtevic dhe Polaçi .

Që nga themelimi, vendbanimi drejtohej nga një kapiten fshati ose plak katundi. Fillimisht ata ishin punëtorë të thjeshtë dhe barinj, mirëpo u bënë shumë shpejt pronarë të pjesës më të madhe të tokës në zonën e Zarës. Ata ishin të parët në rajon që mbollën misër, ishin bujq të mirë, kasap të shquar, prodhues salçiqesh dhe tregtarë bagëtish.

DAIM ILAZI-FIGURA MARKANTE TE ARBËRESHËT E ZARËS

Aty u hap edhe një shkollë fillore mësuesish në vitin 1866 e cila u mbyll në vitin 1921. Në kohën kur Shqipëria u pushtua nga Perandoria Osmane, arbëreshët katolikë u vendosën në Zarë e veriut të Kroacisë, midis shekujve XVII dhe XVIII ndërsa Arbëreshët Ortodoksë emigruan kryesisht në Italinë e Jugut.

Vala e parë e migrimit nisi në vitin 1655, dhe shkuan në Pulë dhe Istër. Një valë e dytë, në 1726-27 dhe 1733 shkuan dhe u integruan në sferën sociale dhe ekonomike të Dalmacisë Veneciane. Në disa qytete të tjera bregdetare filluan që të asimilohen, kurse në Zarë, ata ishin në gjendje të ruajnë gjuhën dhe zakonet e tyre.

Në fakt, arbëreshët u vendosën në periferi të Zarës në një tokë kënetore të një pronari venecian Erizzo, një lokalitet i njohur më vonë si Borgo Erizzo / Varosh Eriçina ose Arbënesh /Arbanasi. Origjina e arbëreshëve të Zarës është nga treva e Krajës, gjegjësisht nga fshatrat Brisk, Shestan dhe Podë, sot pjesë e Malit të ZI.

Emërimi kroat për arbëreshët e Zarës është *Arbanasi*, që është një etnonim i vjetër që sllavëte përdornin për shqiptarët, e që daton nga mesjeta. Fshati Arbanasi do të bëhej ambienti kryesor ekonomik në sektorin e ushqimit në Zarë, për dy shekujt e gjysmë të ardhshëm.

Shpërnguljet e shqiptarëve nga trojet e tyre kurrë nuk janë ndërprerë tërësisht, por varësisht nga rrethanat shoqëroro-historike, dhuna, presioni, apo gjendja sociale, herë-herë është shtuar e herë-herë është zvogëluar intensiteti i tyre. Ka pasur shpërngulje që bëheshin në mënyrë të organizuar si edhe në forma individuale.

Fatkeqësisht ato po vazhdojnë edhe në ditët e sotme, për dallim nga shpërnguljet e kaluara, tani nga trojet tona po ikë rinia për shkaqe ekonomike edhe inteligjencia, truri dhe shpresa e kombit. Pra, po ndodh jo vetëm tkurrja, varfërimi biologjik, por edhe ai intelektual i kombit.

Ky fenomen po vazhdon sot edhe në kohët kur mendohet se po konsolidohen demokracitë edhe në ato vende ku

DAIM ILAZI-FIGURA MARKANTE TE ARBËRESHËT E ZARËS

jetojnë shqiptarët. Shqiptarët e shpërngulur, kudo ku kanë shkuar, kanë krijuar enklava, në të cilat kanë ruajtur zakonet, traditat, gjuhën dhe kujtimet e pa harruara të atdheut stërgjyshor.

Një degëzim ndër to është edhe vendosja e arbëreshëve të Zarës në Kroaci, i themeluar në shekullin XVIII prej zonave të veriut të Shqipërisë. Arbëreshët e Zarës i dhanë Kroacisë dhe Evropës personalitete markante. Komuniteti arbëreshëve të Zarës e ka ruajtur gjuhën, kulturën e trashëgiminë origjinale shpirtërore e kulturore duke i rezistuar gjatë tre shekujve asimilimit.

Shumë shqiptarë të lidhur me Rilindjen Kombëtare dhe, zhvillimin e letërsisë shqipe pas pavarësisë Shqipërisë të vitit 1912, vendosën kontakte dhe vizituan arbëreshët në Zarë, si Faik Konica, Shtjefën Gjeçovi dhe Fan Noli.

Vetë Arbëreshët e Zarës dhanë mbështetjen e tyre pavarësisë së Shqipërisë me një dokument në gjuhët arbëreshe, italisht dhe kroatisht.

Arbëreshët e Zarës, janë me origjinë nga fshatrat përreth Liqenit të Shkodrës, të cilët ishin larguar nga tokat e veta në disa etapa (1655, 1726-27 dhe 1733), përmes Bokës së Kotorit e detit Adriatik dhe kishin arritur me anije në bregdetin kroat afër Zarës, ku edhe sot ekziston komuniteti i tyre edhe pse janë shpërndarë në ndërkohë anembanë Kroacisë.

Nga ky komunitet kanë origjinën shumë njerëz me renome internacional dhe intelektual me famë nga domeni i artit, kulturës, sportit e të politikës në Kroaci e më gjerë: familja e muzikantëve me renome, si: Shime, Valter e Maja Deshpali, këngëtari Gjani Marshan, Tomislav Ivçiq, sportistët Pino Gjergja, vëllezërit Bajko, Kryebashkiaku i Zarës dhe Ministër i Turizmit, Kallmeta, arkeologu e ilirologu me famë evropiane Aleksandër Stipçeviq dhe shumë të tjerë.

Në Arbanas edhe sot gjeneratat e vjetra e flasin gjuhën gegërishte arbëreshe, këndojnë këngë te vjetra në këtë

gjuhë dhe, i ruajnë traditat origjinale të jetës shpirtërore, por për fat të keq, dita ditës janë në proces të vazhdueshëm të asimilimit edhe pse janë të vetëdijshëm dhe krenarë, për rrënjët shqiptare të origjinës së tyre.

Gjani Marshan është njëri ndër yjet e muzikës së lehtë të Kroacisë e ish-Jugosllavisë. Arbëresh nga Zara e Kroacisë, ai doli nga një familje muzikantësh. Edhe dy vëllezërit e tij po ashtu ishin muzikantë.

Zara (Zadar), ka dhënë disa emra të respektuar edhe në muzikën klasike siç është Familja Deshpali e cila ka arritur famë ndërkombëtare.

Të gjithë këta lindën në lagjen Arbanasi të Zarës. Vet kjo lagje ka marrë emrin nga Arbëreshët (Arbanasët), si i quajnë në Kroaci. Lagja Arbanasi u themelua në vitin 1726, atëherë kur këtu filluan të arrijnë shqiptarët e shpërngulur nga Shkodra edhe rrethinat.

Një tjetër Arbanas, gjendet në Bullgari. Ekzistojnë edhe dy vendbanime tjera me emrin Arbanas. Një në Bosnje, afër

qytetit Trebinje si dhe një Arbanas tjetër në Kroaci afër qytezës Sinj.

Pra, vetëm në Kroaci dhe në Bosnje ekzistojnë katër vendbanime me emrin Arbanas dhe gati të gjithë banorët e tyre janë më origjinë arbëreshe. Për ne, më i njohuri është Arbanasi i Zarës, i njohur, pos për detin e bukuritë që ia fali Zoti e natyra piktoreske, por edhe për talentet e tyre në muzikë.

Kjo lagje arbëreshe, që u mbijetoi furtunave, i dha emra të respektuar kulturës kroate, por edhe asaj shqiptare.

Nga sportisti Pino Gjergja, e deri tek njerëzit e penës si Josip Relja dhe, arkeologu, iliriologu me famë evropiane Aleksander Stipcevic, arbëreshët e Zarës u bënë edhe personalitete për admirim. Më të dalluarit ishin muzikantë. Në muzikën klasike më e njohura është familja Deshpali e cila në botën e artit hyri me poetin e kompozitorin Shime Deshpali dhe, vazhdoi me Pavle, Valter e Maja Deshpalin.

Por, faktori kryesor në humbjen e identitetit ishte pamundësia për të mësuar gjuhën shqipe në shkolla.

E vetmja mënyrë e mbajtjes së entitetit dhe identitetit gjuhësor të tyre ka qenë ruajtja e traditës kulturore nëpërmjet riteve, traditave dhe zakoneve të ndryshme. Por, sot vetëm një numër i vogël, d.m.th. të vjetrit e flasin arbërishten, në dialektin gegë.

Abreshët kanë dhënë kontribut të madh për Zarën e Kroacinë, që nuk mund të mohohet.

Edhe me rastin e manifestimit të organizuar, për nder të hapjes së bibliotekës në Arbnes, më 23 nëntor 2008, Kryebashkiaku i Zarës, Zhivko Kolega, ndër të tjera duke folur për kontributin e madh të arbëreshëve dhënë për qytetin e Zarës ka thënë: Të gjithëve u është i njohur roli arsimor i mësuesve të shumtë arbëresh, priftërinjve, intelektualëve, por edhe roli i tyre në shtrirjen e vetëdijes nacionale kroate, në mesin e gjerë të banorëve të Zarës dhe rrethinës.

Po në të njëjtin manifestim në fjalën e rastit që e kishte përgatitur Aleksandër Stipçeviq, për rolin e arbëreshëve të Zarës prej kohësh dhe përmendi intelektualët, sportistët, politikanët e njohur, si:

- Luqi Pavo Rela,
- Ivo Petani,
- Josip Gjergja,
- Kruno Krstiq,
- Akademik Augustin Stipçeviq,
- Shime Deshpali,
- Bonifacije Peroviq,
- Niko Moroviq,
- Hrvoje Mazija,
- Familjen Deshpali,
- Këngëtarët eminent Tomislav Ivçiq, Gjani Marshan,
- Ivica Mateshiq,
- Bozhidar Kalmeta,

- Shime Duka,
- Pino Gjergja, vllazërit Bajlo, etj.

Ndërsa publicisti i njohur Zarës, Drago Mariq, duke u shpreh për kontributin e tanishëm të arbëreshëve në çdo lëmi në qytetin e Zarës, thotë: Konsideroj, që sot popullata arbëreshe e Zarës, në rend të parë inteligjencia e saj, është forcë prijëse në këtë qytet. Edhe në luftën për çlirimin e Kroacisë nga ushtria serbo-jugosllave, morën pjesë një numër i konsiderueshëm i arbëreshëve, si Kolonel Ivica Mateshiq, që është edhe poet, komandanti i brigadës Danijel Kotlar, pastaj Bernard Paleka, Bozhidar Kallmeta (ministër medy mandat në Qeverinë e Kroacisë) etj.

Disa janë edhe dëshmorë. Pra, edhe kësaj radhe në kohën e agresionit serbomadhi të regjimit Milosheviqit, arbëreshët dëshmuan lojalitetin ndaj Kroacisë.

Në këtë libër, dua t'i shënojë dhe potencoj personalitete arbëreshe me famë internacionale, që shumica për

gjeneratat e reja te ne në Maqedoninë e Veriut, por edhe në Kosovë apo në Shqipëri, janë gati të panjohur.

Po ashtu dua të theksoj që sot, për fat të keq, pak njerëz të rinj e flasin gjuhën e tyre autoktone — arbërisht.

Por një është e qartë se arbëreshët, janë të vetëdijshëm, se origjina e tyre nuk është sllave, se të parët e tyre janë nga viset shqiptare, janë arbëresh por edhe kroat me shtetësi kroate.

Në këtë libër do t'i analizoj në mënyre të detajuar personalitete arbëreshe me famë evropiane që kanë lënë gjurmë të pashlyera në jetën politike, kulturore, sportive në Kroaci dhe jashtë saj si në Evropë e në mbarë botën.

Në muzikën e lehtë, familja më e njohur arbëreshe e Zarës, janë vëllezërit Gjani Marshan dhe Tomisllav e Vedran Ivcic. Pak dihej që këta, të tre - janë vëllezër, për shkak se mbajnë mbiemra të ndryshëm.

Sot nuk janë tre, pasi që vëllai i dytë gjysmë vëllau, Tomisllavi, disa vite më herët ka ndërruar jetë shumë i ri,

pas një fatkeqësie komunikacioni. Gjani Marshan, u bë m'i njohuri prej tyre në vitet e 70-ta. Marshan këndoi gati në të gjitha festivalet më të njohura në ish-Jugosllavi, si edhe në botën e jashtme. Këndoi e jetoi disa vite në Gjermani dhe pastaj në Itali, SHBA, Australi, Francë, e disa vende tjera. Ka këngë të incizuara edhe për produksione të jashtme, në gjuhën gjermane, italiane kroate e angleze. Në kohën e tij dominonte muzika e lehtë me tone mediterane dhe kancone italiane. Ai u radhitë ndër këngëtarët më të mëdhenj të ish-Jugosllavisë. Pas pavarësimit të Kroacisë, Marshan hyri në politikë dhe më vonë edhe në diplomaci. Shërbeu si Konsull Gjeneral i Kroacisë në Trieste, e Milano të Italisë si dhe në Australi.

Gjani Marshan sikur ndoqi shembullin e shansonjerit të madh francez Charl Aznavur, i cili në vitet e fundit u bë ambasador i Armenisë në Zvicër. Aznavur me origjinë është armenian.

Nga mjeshtrit e penës me origjinë nga Zara, pos Shime Deshpalit, njihet edhe Josip Rela, i cili një kohë shërbeu arsimtar në shkollat shqipe në Plavë-Gucisë. E njohim posaçërisht për dramën e tij "Nita", të shfaqur në disa teatro të Kosovës në vitet e 80-ta por edhe te ne në Maqedoninë e Veriut. Arbëreshët e Zarës dhe lagja e tyre Arbanasi, është e njohur edhe për sport.

Basketbollisti m'i njohur në historinë e Kroacisë dhe Jugosllavisë, Josip Pino Gjergja doli po nga kjo vatrë.

Një personalitet tjetër me po këtë emër e mbiemër ishte diplomat dhe kryetar bashkie i Zagrebit në vitet e 70-ta, Josip Gjergja ishte politikan e diplomat në kohën e ish Jugosllavisë dhe jetoi disa vite në Tiranë.

Pas Luftës së Dytë Botërore ai shërbeu ambasador i Jugosllavisë në Shqipëri. Muzika, sporti, poezia e diplomacia, mbesin dashuritë e pasionet e arbëreshëve më të njohur të Zarës. Në sport, arbëreshët e Zarës njihen veçanti për çiklizëm, futboll dhe basketboll. Vilson Xhoni

DAIM ILAZI-FIGURA MARKANTE TE ARBËRESHËT E ZARËS

është i lindur më 24.09.1950, në Split të Kroacisë. Si dhe futbollisti KF Hajduk nga Spliti, Dinamo Zagrebit, Schalke 4 Gjermani etj., dhe ish-reprezentues i ish- Jugosllavisë.

Wilson Xhoni dallohej si lojtar i shpejt, depërtues i suksesshëm, dhe mbrojtës modern. Ishte reprezentues i Jugosllavisë katër herë.

Çështje e rëndësishme është edhe sa do të jetë e pranishme gjuha arbërishte në mesin e arbëreshëve të Zarës. Aty ku më parë ishte zhdukur ilirishtja e tani edhe të njëjtin fat do ta ketë arbërishtja. Intelektualët e shquar arbëresh si:


- Rela,
- Deshpali,
- Kruno Krstiçi,
- Gjani Marshan,
- Aleksandar Stipçeviq,

Si edhe të tjerë, që ishin të vetëdijsëm se një përfundimimi këtillë do të ndodhë.

Prandaj ata përpiqeshin për ta shkruar gjuhën arbërishteshqipe dhe kërkonin që ajo të mësohet edhe në shkollë. Do të ishte dobiprurëse dhe akt fisnik hapja e Konsullatave nderidhe, qendra kulturore shqiptare nga Shqipëria dhe Kosova në Zarë, për ruajtjen e identitetit kulturor, gjuhësor dhe kombëtar të këtyre arbëreshëve që kudo krenohen me origjinën e tyre.

Është mirë, kohë pas kohetë ftohen si mysafir në skenat tona muzikore, në simpoziume shkencore në Tiranë, Prishtinë, Shkup, Tetovë, këto personaliteteme vlera evropiane. Pra do të fillojnë mënyrë më të detajuar me një ndër intelektualët e lartë, akademik: Aleksandar Stipçeviq.

Aleksandar Stipçeviq



Aleksandër Stipeviqi, u lind më 10 tetor 1930 në Arbëresh të Zarës në Kroaci. Është njëri nga ata djemtë arbëreshëve të rrethit të Shkodrës, të cilët treqind vjet më parë u shpërngulën në rrethin e Zarës. Në Zarë ndoqi shkollën fillore dhe të mesme si dhe u diplomua për arkeologji në Fakultetin filozofik në Zagreb, në vitin 1954.

Në vitin 1977, mori titullin Doktor i Shkencave, në Fakultetin Filozofik të Zarës, me temën: Kultet fetare në Iliri.

Për një kohë të shkurtër punoi në Muzeun Arkeologjik të Zarës dhe në Institutin e Shkencave Historike në Zarë, ndërsa në vitin 1957 kaloi në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare në Zagreb në detyrën e shefit të Departamentit për libra. Në vitin 1974, merr postin e Drejtorit të Bibliotekës Universitare dhe, në fund të vitit 1983 kaloi në Institutin Leksikografik — Miroslav Krležha, ku merr detyrën e Kryeredaktorit të Leksikut biografik kroat.

Në nëntor 1987, transferohet në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit, Departamenti i Shkencave të Informacionit. Kurse në Departamentin e bibliotekës ka drejtuar një varg institucionesh e projektesh, që lidhen me bibliotekat, historinë e librit, botime enciklopedike etj.

Që nga viti 1987, është Profesor ordinar, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit, ku i mbante ligjëratat e historisë së librit, sociologjisë së librit dhe bibliografisë. Është autor i një numri të madh veprash për ilirët dhe, historinë e librit, si:

- Historia e ilirëve,
- Arti i ilirëve,
- Simbolet e kultit të Ilirët,
- Bibliografi për ilirët,
- Historia e librit,
- Censura në biblioteka,
- Interpretime albanologjike etj.

Më shumë se dyzetë vjet emri i tij identifikohet me rezultatet më të reja të studimeve ilire. Librat e tij, janë botuar në shumë gjuhë botërore.

Aleksandër Shandri Stipçeviqi, vdiq më 31.08.2015 në Zagreb. Që nga viti 1983 është anëtar i Akademisë së

Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe, që nga viti 2001, anëtar i jashtëm i Accademia Marchigiana di Scienze, Lettere ed Arti, në Ankona. Ai ka qenë anëtar i PEN Qendrës Kroate, që nga viti 1985, si dhe i Shoqatës Kroate Arkeologjike, që nga viti 1966.

Për punën e tij, është nderuar me çmime dhe mirënjohje të shumta, si: Çmimin e qytetit të Zagrebit, në vitin 2004 dhe, në të njëjtin vit, Çmimin për arritje jetësore të qytetit të Zarës.

Është vlerësuar edhe me medalje nga Fakulteti Filozofik i Universitetit të Zagrebit, për meritat më të larta dhe rezultatet e arritura në punët shkencore, teorike dhe praktike (2006). Po ashtu iu dhanë edhe çmimet më të larta shtetërore shqiptare: Urdhri i artë "Naim Frashëri", për kontributin e tij për "Ndriçimin e historisë së Ilirisë" (2001) dhe, dekorata "Skënderbeu", dekoratë e dhënë nga Presidenti shqiptar, për shqiptarët më të njohur, që promovojnë kulturën shqiptare në botë

Në vitin 1978, u zgjodh Profesor i asociuar me kohë të pacaktuar në departamentin e sapokrijuar të shkencave bibliotekare në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit dhe, në vitin 1987, u zgjodh Profesor ordinar në të njëjtin fakultet. U pensionua në vitin 1997. Nga viti 1987-1996, ka qenë shef i Departamentit të Bibliotekës në Departamentin e Shkencave të Informacionit, dhe nga viti 1992-1995, ishte udhëheqës i Departamentit të Shkencave të Informacionit në Fakultetin Filozofik në Zagreb.

Ai mbajti një sërë postesh përgjegjëse, në organizatat bibliotekare nga viti 1967 e deri në vitin 1973, ai gjithashtu ishte Kryetar i Shoqatës Kroate të Bibliotekave dhe, nga 1967-1969, ishte Nënkyetar i Shoqatës së Bibliotekistëve të Jugosllavisë.

Nga viti 1992-1997, ka mbajtur postin e Kryetarit të Këshillit për bibliotekat e Republikës së Kroacisë.

Në periudhën 1993-1996, ai ishte edhe anëtar i Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe, të Drejtat e Bashkësive dhe,

Pakicave Etnike dhe Kombëtare të Dhomës së Përfaqësuesve të Parlamentit Shtetëror të Republikës së Kroacisë.

Mori pjesë në shumë tubime e seminare shkencore në vend dhe, në mbarë botën. Ai ishte në udhëtime dhe qëndrime studimore në Itali, Gjermani, Angli, Korenë Jugore, Jordani, Turqi, Danimarkë, Shqipëri dhe, në shumë vende të tjera.

Veprat më të njohura:

- *Gli Iliri* ("Illyrians";1966)
- *Arte degli Illiri*("The Illyrian Art"; 1963)
- *Iliri:povijest, život, kultura*(1974)□ *Bibliografija antičke arheologije u Jugoslaviji* (I–II, 1977)
- *Kultni simboli kod Ilira* ("The Illyrian Cult Symbols"; 1981)
- *Povijest knjige* ("The History of Books"1985, 2006);

- *Cenzura u knjižnicama* ("Censorship and Libraries"; 1992) □ *O savršenom cenzoru* (1994);
- *Sudbina knjige* (2000);
- *Socijalna povijest knjige u Hrvata* (I–II,2004–05);
- *Tradicijska kultura zadarskih Arbanasa (Historia tradizionale e arbëreshëve të Zarës* - 2011).

Valter Deshpali



Valter Deshpali, u lind më 5 nëntor 1947, në Zarë dhe vdiq, më 9 prill 2023 në Zagreb. Ky artist dhe njeri i jashtëzakonshëm, një muzikanti gjithanshëm dhe me famë ndërkombëtare, ishte një violonçelist i shkëlqyer, aktiv si solist, muzikant dhome, pedagog dhe producent muzikor. Deshpali, djali i kolosit Shime Deshpali, lindi në Zarë më 5 nëntor 1947.

Ai u diplomua për violonçeli në Shkollën Juilliard në Nju Jork, në klasën e Leonard Rose dhe, më pas studioi në Konservatorin e Moskës, në klasën e Galina Kozolupova dhe, Pablo Casals, Pierre Fournier dhe André Navarre.

Karriera e tij brilante ndërkombëtare si solist e ka dërguar atë në audienca pothuajse në të gjitha vendet evropiane dhe, ndër të tjera, në SHBA, Kanada, Australi, Kinë, Indi dhe Iran. Ai performoi në sallat më të famshme dhe prestigjioze të koncerteve si Carnegie Hall në Nju Jork, Kennedy Center në Uashington, Shtëpia e Operës së Sidneit, Royal Festival Hall në Londër, Concertgebouw në Amsterdam, Salla e Madhe e Konservatorit të Moskës, Salla e Filarmonisë në Shën Petersburg etj.

Ka bashkëpunuar me kompanitë diskografike në Kroaci, Gjermani, SHBA dhe Rusi.

Ai regjistroi një sërë materiale diskografike, që dëshmojnë për përsosmërinë e interpretimit, duke reflektuar mendimet

dhe kuptimin e tij për muzikën, si dhe muzikantin e shkëlqyer.

Nën drejtimin e dirigjentëve të shquar (Lovre Mataçiç, Sergiu Commission, Günther Herbig, James Conlon, Vernon Handley, Hiroyuki Iwaki, Howard Mitchell, David Zinman, Andrzej Markowski), Deshpali, ishte një solist me orkestrat kryesore të metropoleve kulturore, në tre kontinente.

Në muzikën e dhomës, ai ishte partner i artistëve të mëdhenj si Gidon Kremer, Dmitrij Sitkovjetski, Yo-YoMa, Heinrich Schiff, Philippe Entremont, Jurij Bašmet, Irena Grafenauer dhe Tabea Zimmermann.

Nga viti 1972 punoi si Profesor i violonçelit, në Akademinë e Muzikës në Zagreb dhe, ishte Profesor vizitor në disa universitete si në SHBA dhe Australi. Në fushën e pedagogjisë, ai arriti rezultate po aq të mëdha, sa në karrierën e tij muzikore.

Ai themeloi dhe drejtoi Ansamblin Cellomania, i cili arriti sukses të madh në shfaqje të shumta, shpesh ishte i ftuar në Lojërat Verore të Dubrovnikut, në Lubjanë, Vjenë, Paris, Amsterdam dhe Moskë, së bashku me disa nga violonçelistët më të shquar botëror.

Ai themeloi dhe drejtoi festivalin e artistëve të rinj në Zarë dhenë vitin 1996, ai themeloi një shkollë muzikore për të rinjtë e talentuar në Zagreb.

Për arritje jetësore në fushën e muzikës klasike ai është fitues i çmimit Ivo Maček dhe i çmimit Vladimir Nazon, i qytetit të Zagrebit, i çmimit Milka Trnin dhe i çmimit Lovro Mataçiç i Shoqatës Kroate të artistëve muzikorë.

Shime Deshpali



Shime Deshpali, muzikant dhe shkrimtar i lindur në Arbëresh afër Zarës, 16.II.1897 dhe vdiq më 16.I.1981, në Zagreb. Ai studioi për muzikënë vitet 1912-1915 në Zarë ku mori edhe arsim muzikor, duke studiuar me F. Lederer (vokale, harmoni),

F. Spade (violinë), dhe dirigjim. Gjatë Luftës së Parë Botërore, ai ndërpreu shkollimin për shkak të shkuarjes në fushën e betejës (1915– 18).

Pas kthimit në Zarë, ai vazhdoi të studionte privatisht dhe filloi të kompozonte dhe drejtonte një ansambël kori dhe trombësh.

Pasi u largua nga Jugosllavia në vitin 1921, pas disa vitesh kthehet dhe punoi deri në vitin 1943 në disa ujdhesa të Kroacisë, Hvar, Rab, Pag dhe Blat të Korçulës si organizator i jetës muzikore, dirigjent, kompozitor dhe pedagog.

Në Hvar, ai bashkoi një orkestër të vogël dhe, një kor të dajreve të grave, në Rab, ai drejtoi muzikën frymore dhe një kor të grave, në Pag themeloi dhe drejtoi grupin korit të qytetit, dhe në Blat themeloi dhe drejtoi orkestrën, një kor të përzier me muzikë frymore, të cilën ai e ngriti ndër ansamblet më të mira të këtij lloji në Dalmaci.

Në vitin Më 1943 u bë drejtor artistik i grupit kulturor-artistik i partizanëve të rrethit të Dubrovnikut, kurse më 1944/45, dirigjent i orkestrës së Teatrit të Qarkut në Dubrovnik.

Pas kthimit në Zarë në vitin 1945, emërohet drejtor i Teatrit Kombëtar, ku riorganizoi ansamblin e aktrimit dhe themeloi e drejtoi korin dhe orkestrën. Nga viti 1946 deri në vitin 1973, ai iu përkushtua punës pedagogjike dhe dha mësim teorinë e muzikës dhe instrumentet me tela në Shkollën e muzikës në Zarë, si dhe themeloi dhe drejtoi korin dhe orkestrën e shkollës; në të njëjtën kohë ishte në Liceun klasik në vitin 1946/47 mësues i edukimit muzikor dhe nismëtar i një kori të përzier dhe, që nga viti 1947, filloi të jep mësim teorik dhe didaktikë muzikore në shkollën e mësuesit. Mëvonë, themeloi dhe drejton një kor të madh tamburash.

Përveç kësaj, ai ishte organizator dhe dirigjent i Korit Qendror të Rinisë Zarë (1946).

Përveç kësaj, ai ishte organizator dhe dirigjent i Korit qendror të rinisë së Zarës (1946), pastaj i korit të përzier të Fakultetit Filozofik dhe nga viti 1951 i korit të përzier të Shoqërisë kulturore arsimore "Arbëreshët/Arbanasi".

Ai kompozoi vepra për orkestër harqesh, për orkestër frymore dhe përkor. Gjashtë këngë të tij korale u botuan në përmbledhjen “Këngë slëvante” Prishtinë 1973.

Shprehjen kompozicioneve muzikore e zhvilloi duke u mbështetur në folklor. Ai shkroi vjersha edhe tregime në gjuhën e arbëreshëve të Zarës. Shime Deshpali, pati djalin Valter Deshpali, muzikant me famë evropiane e botërore dhe vajzën Maja Deshpali po ashtu muzikante markante.

Veprat:

- Tregime Arbëneska (prozë). Prishtinë, 1966,
- Agimete Arbëneshit (poezi).Prishtinë,1968,
- Ewita (këngë). Prishtinë në vitin1972.

Maja (Marija) Deshpali Begoviq



Maja Deshpali, vajza e Shime Deshpalit, ishte violiniste dhe pedagoge e njohur arbëreshe. Ajo u lind në Blato në ujdhesën Korçulë, më 6 maj 1942. Mësimet e para për violinë dhe piano i mori nga babai i saj Shime, muzikant dhe shkrimtar; vazhdoi studimet në Zagreb në Shkollën e muzikës "Vatroslav Lisinski", ku u regjistrua në piano dhe pas provimeve përfundimtare në vitin 1963, kaloi në

studimet për violinë në Akademinë e muzikës dhe u diplomua në vitin 1966, duke fituar çmimin "Václav Huml".

Ajo studioi në Konservatorin Peabody në Baltimore. Pas kthimit në Zagreb, Maja u diplomua në vitin 1971 në Akademinë e muzikës.

Që nga viti 1966 me ndërprerje është anëtare e Orkestrës Simfonike të RTV Zagrebit (në vitin 1971/72 zv. koncert udhëheqëse), nga viti 1972 deri në vitin 1987 udhëheqëse e Orkestrës së Operës e Teatrit Kroacisë, dhe që nga viti 1987, Profesoreshë në Akademinë e Muzikës në Zagreb dhe që nga viti 1991, shef i Departamentit të instrumenteve me Tela dhe Kitarë.

Për një kohë të shkurtër ishte edhe violiniste e Trios së Pianos së Zagrebit (1971/72). Në të njëjtën kohë, pas përfundimit të studimeve, ajo filloi karrierën e saj koncerteve, duke interpretuar si soliste dhe me orkestra

pothuajse në të gjitha qytetet kryesore të Jugosllavisë dhe jashtë saj (Austri, Bullgari, Spanjë, SHBA, BRSS).

Ajo mori pjesë në shumë festivale muzikore vendase dhe ndërkombëtare, dhe me muzikalitetin e saj të rafinuar, ndjenjën e stilit veçantë ajo shpejt u radhit në mesin e artistëve më të mirë kroatë të violinës.

Me interes të veçantë janë performancat e saj me vëllain e saj, violonçelistin markant Valter Deshpali.

Shime Deshpali, kishte dy djem Valterie Pavle dhe, vajza Maja Deshpali.

Ai, themeloi Mbrëmjet Muzikore të Zarës, në Shën Donat dhe, Orkestrën e dhomës së Zarës. Ai është Kryedirigjenti Orkestrës kroate, të dhomës dhe Orkestrës Simfonike, të Radio Televizionit Kroat .

Pavle Deshpali



Pavle Deshpali, djali Shime Deshpalit, një dirigjent dhe, kompozitori si dhe akademik eminent kroat.

Pavle Deshpali lindi në Blato të Korçulës më 18 qershor 1934. Ai u rrit në një familje të shquar muzikore me vëllanë e tij Valterin, violonçelist dhe motrën Maja, violiniste, kurse mësimet e para muzikore i mori nga i ati Shime Deshpali.

Ai mësoi notat në moshën katër vjeçare, nëna e tij Katica, dinte të luante piano dhe, ai me talentin e rrallë dinte të performonte notat. Ai filloi të dirigjojë, kur ishte vetëm pesë vjeç. Pastaj babai i tij u sëmur, por ai i mbijetoi pneumonisë së atëhershme vdekjeprurëse. Në vitin 1939, babai u sëmurë rëndë, nuk mundi ta mbante koncertin, kështu që djali i vogël Pavle, e drejtoi koncertin.

Ai shkroi kompozimet e tij të para në moshën gjashtë vjeçare. Instrumenti i tij i parë ishte piano, të cilën ai filloi ta luante sapo arriti te tastet dhe më pas filloi të luante violinë. Babai i tij e mësoi të luante të dy instrumentet, ai gjithashtu ia mësoi bazat e kompozimit.

Pavle Deshpali u diplomua në Zarë në vitin 1952.

Në rininë e tij, ai ndihmonte të atin si shoqërues, interpretoi si solist, si pianist dhe violinist, po ashtu luajti në Filarmoninë e Zarës dhe kompozoi muzikë skenike, për teatrin e Zarës.

Kur babai i tij vdiq, nëna e tij ndërroj vendbanimin, kështu që, baza e tyre e përhershme ishte në Zagreb.

Në vitin 1952 regjistrohet në Akademinë e Muzikës në Zagreb për të studiuar kompozicion në klasën e profesorit eminent Stjepan Šulek, i cili më vonë deklaroi se nuk kishte takuar një person më të talentuar në jetën e tij.

Nga viti 1968, ai ishte dirigjent, dhe nga 1970 deri në 1981, drejtor artistik i Orkestrës Simfonike të Floridës dhe Operës në Orlando, Florida. Pavle Deshpali qëndroi në Amerikë deri në vitin 1981.

Nga viti 1981 deri në vitin 1986, ka qenë Kryedirigjent i Filarmonisë së Zagrebit. Nga viti 1981 deri në vitin 1983 ka qenë edhe drejtor i programit muzikor të Festivalit Veror të Dubrovnikut.

Nga viti 1987 deri në vitin 1995, ai ishte profesor i rregullt i dirigjimit në Akademinë e Muzikës në Zagreb.

Nga viti 1995 deri në 1998, ai ishte dirigjent i Filarmonisë së Tokios Geidai dhe profesor në Universitetin Kombëtar të Tokios.

Nga viti 1998 e deri më sot ka qenë kryedirigjent i Orkestrës së Dhomës Kroate.

Nga viti 2000 deri në vitin 2009, ai ishte Kryedirigjent i Orkestrës së Dhomës së Splitit.

Ai është dirigjent i ftuar i orkestrave të shquara kroate si dhe i Operës dhe Baletit të Operës Kombëtare Kroate. Në vitin 2010, ai u bë udhëheqës artistik dhe dirigjent i Orkestrës Simfonike të RTV Sllovenisë. Në vitin 2011, ai u bë kryedirigjent i Orkestrës Simfonike RTV Kroacisë.

Pavle Deshpali, si dirigjent eminent ishte i ftuar në orkestra simfonike prestigjioze të huaja në Luksemburg, Tuluzë, Milano, Frankfurt, Bratislavë, Salzburg, Budapest, Bukuresht dhe Moskë.

Ai ka drejtuar gjithashtu Filharmoninë Mbretërore të Londrës, Orkestrën Simfonike Shtetërore Ruse të Moskës,

Filarmoninë e Novosibirskut, Orkestrën Simfonike të Pitsburgut, Orkestrën e Festivalit të Çikagos në Grand Park, Filarmoninë e Tokios, Orkestrën Simfonike të Tokios etj. Ishte krenar që ishte edhe arbëresh. Ishte nënkryetar i Akademisë shkencave e arteve të Kroacisë. Në vitin 2021, vdiq në Zagreb.

Josip Rela



Josip Rela ishte, mësues, poet, prozator dhe dramaturg i shquar nga Arbneshi i Zarës, Kroaci.

Josip Rela, u lind më 1895 dhe, u rrit në fshatin Arbanastë Zarës. Në vendlindje kreu arsimin fillor dhe shkollën normale të Zarës. Fillimisht ishte mësues në ishullin Rab. Gjatë Luftës së Parë Botërore u angazhua për themeliminë shkollave shqipe në Vuthaj, Triesh dhe Arzë (Malësi e Madhe).

Më vonë ka punuar si mësues, drejtor shkolle dhe drejtor teatri në Zarë, dhe në vise tjera të Dalmacisë e Kroacisë. Shkroi poezi, tregime dhe vepra dramatike (komedi dhe drama). Është autor i 16 dramave në gjuhën shqipe ndër të cilat "Nita", është më e njohura dhe, është luajtur shpesh nga grupet teatrore në Kosovë dhe, në Maqedoninë e Veriut.

Josip V. Rela konsiderohet si themelues i dramaturgjisë shqiptare në ish Jugosllavi. Në edicionin e revistës "Jeta e re", me 1952 u botua drama e tij e parë "Martesa". Kryevepra e tij, drama "Nita", pati edhe disa ribotime, në Prishtinë, në Tiranë dhe, në botim dy gjuhësh, arbërisht dhe

kroatisht, në Zarë me 2014, si dhe u vendos në shumë skena teatrore nga grupe amatore dhe profesioniste. Vdiq në vitin 1966 në Zarë.

Veprat më të njohura janë:

- Kungulli(1953),
- Nita(1954),
- Zani i fëmiut(1963),
- Vjersha(1964),
- Dila (1965), Fisi i mallkuam(1966),
- Sot tetë ditë, etj.

Gjani Marshan



Gjani Marshan, arbëresh, njihet për publikun si këngëtar i madh, kompozitor dhe diplomat. Ai u lind në Zarë më 23 qershor 1944. Në karrierën e tij si këngëtar, regjistroi albume të shumta për të cilat u shpërblye disa herë.

Krahas këngës dhe kompozimit, ai për shumë vite u angazhua edhe në punë diplomatike, duke mbajtur postin e Ministrit, Këshilltar në Ambasadën e Republikës së Kroacisë, në Selinë e Shenjtë, në Vatikan si dhe në Urdhrin Sovran të Kalorësve të Maltës.

Më vonë, ai punoi si Konsull në Trieste, Perth, Australi dhe në fund Konsull gjeneral i Kroacisë në Milano.

Gjani Marshan, u shkollua në Zarë, ku mbaroi shkollën fillore dhe më pas hyri në shkollën e mesme detare.

Pasi mbaroi shkollën e mesme, punoi si oficer në një anije për dy vjet. Pas kësaj, ai hyri në Kolegjin e tregtisë së jashtme në Zagreb, ku u diplomua në vitin 1969, dhe iu përkushtua karrierës muzikore.

Gjani Marshan, vjen nga një familje e shquar arbëreshe dhe të vendosur në Arbanas në Zarë.

Gjani flet në mënyrë aktive anglisht dhe italisht. Përveç kësaj, ai flet rakisht dhe gjermanisht, po ashtu flet shqip, gjuhën e prindërve dhe gjyshit.

Dy vëllezërit e Gjanit, Vedran dhe Tomislav Ivçiq, poashtu u morën me muzikë, dhe si këngëtarë profesionistë ishin në kombinacionin e top listave në Kroaci dhe në ish-Jugosllavi. Tomislav Ivçiq, ishte një nga këngëtarët më të

njohur kroat i cili vdiq i ri tragjikisht në komunikacion më 4 mars 1993.

Gjani është në lidhje farefisnore me këngëtarin e njohur kroat Mladen Grdoviq.

Karrierën si këngëtar efilloinë vitin 1969 pasi u diplomua në Shkollën e Lartë të tregtisë së jashtme. Zhanri i muzikës me të cilin ai ka qëndruar konsistent gjatë gjithë këtyre viteve është pop dhe shansone kroate. Ka marr pjesë në gjitha festivalet e muzikës së lehtë, muzikë argëtuese në qendrat kryesore e ish-Jugosllavisë.

Në karrierën e tij të pasur muzikore, Gjani Marshan, regjistroi më shumë albume dhe, është autorimë shumë se 80 kompozimeve, ndër të cilat më të njohurat janë:

- Adio,
- Dritare drejt perëndimit,
- Kur lulëzojnë bajamet,etj.

Përveç regjistrimit të këngëve në gjuhën kroate, bien në sy edhe ato në gjuhë të tjera, si:

- anglisht,
- gjermanisht,dhe
- italisht.

Gjatë Luftës në Kroaci si luftëtar për lirinë e shtetit nga Serbia, kur u takua me viktimën e parë, asokohe gjashtëmbëdhjetëvjeçarin Josip, ai kompozoi një këngë në Petrinjë, që ia kushtoi këtij djaloshi. "Lutja për Josipin" ishte një baladë vajtuese që ishte një hitim'imadh radiofonik në atë kohë e krahasuar me himnin e Kroacisë. Këngëtar me famë evropiane ai performoi në Australi, Zelandën e Re, ish-BRSS dhe, në shumë vende evropiane. Performoi shpesh në Nju Jork, Atlanta, Berlin, Paris dhe San Remo. Në intervista të ndryshme shpesh herë me krenari e ka potencuar prejardhjen e tij arbëreshe, në shumë intervista deklaroi se prindit i ka me prejardhje

shqiptare, arbëresh dhe se vajza e tij e vetme, quhet Teuta dhe e mban me krenari këtë emër.

Po e shtojnë pjesë nga intervista e tij, dhënë revistës “Iliria”, në Zagreb më 02.06.2021, i cili flet për jetën e vet si këngëtar me renome evropiane, si diplomat dhe, raportet me Shqipërinë e Kosovën.

Intervista e realizuar nga: Shenida Bilalli

Iliria:

- Zoti Marshan, nga vini ju?
- Rrënjët e tua?

Gjani Marshan: Natyrisht, paraardhësit e mi erdhën bashkë me të tjerët shqiptarë nga zonat e rrethit të liqenit të Shkodrës, para 3 shekuj.

Iliria: Babai dhe nëna janë me origjinë shqiptare apo janë nga një martesë e përzier?

Gjani Marshan: Babai dhe nëna, janë që të dy shqiptarë. Mbiemri i nënës ishte Krstiqi, por ata ishin nga Arbanasi

dhe, të gjithë paraardhësit e tjerë janë pak a shumë nga Arbanasi. Unë, mbetaherët pababa, isha vetëm 9 muajsh. Unë dhe motra ime Tina, jemi të vetmet nga e njëjta nënë dhe baba. Më vonë, nëna ime u rimartua me Shima Ivçiqin. Unë kam dy gjysmë vëllezër, Vedranin dhe Tomislavin, të dy këngëtarë të njohur në Kroaci e ish-Jugosllavia dhe, për fat të keq, që të dy vdiqën shumë të ri. Fatkeqësisht, prindërit e mi nuk janë më të gjallë, e as vëllai im, Tomislav, i cili vdiq në një aksident në vitin 1990. Njerku im zëvendësoi babin tim, në kuptimin e mirëfilltë, ishte prind i sjellshëm, ai ishte një njeri i madh.

Iliria: Si dhe kur filloi karriera e juaj muzikore?

Gjani Marshan: Që në shkollën fillore isha ndryshe nga të tjerët. Unë isha vetvetja dhe pak më ndryshe. E dija që duhej të punoja shumë për të qenë i barabartë me të tjerët. Si i ri jam marr me muzikë dhe, në Zarë të gjithë më njihnin për muzikë.

Karriera ime muzikore, me një ndërprerje për shkak të karrierës sime diplomatike, vazhdon edhe sot e kësaj dite. Kam regjistruar rreth pesëmbëdhjetë albume, më shumë se njëqind këngë, për të cilat kam shkruar muzikë, tekste dhe tekste. Dhe kam udhëtuar shumë nëpër botë: kam qenë në Australi 15 herë, në Amerikë të paktën pesëdhjetë herë dhe në ish-Bashkimin Sovjetik.

Nëish-RDGJ, Gjermaninë lindore, në atë kohë isha më popullor se në Jugosllavi.

Vetëm në gjermanisht kam regjistruar mbi njëqind këngë dhe kam fituar çmime në festivalet e tyre. Sigurisht që më vonë për shkak luftës në ish-Jugosllavi dhe, ngjarjet e vitit 1990 u kthevën për shkak të agresionit serb kundër Kroacisë, që ta mbrojë vendin tim.

Iliria: Si filluat, me diplomacinë?

Gjani Marshan: Mundësia e shërbimit diplomatik, erdhi nga në një bisedë shumë spontane me Presidentin e Republikës së Kroacisë, të ndjerin Z. Franjo Tugjman.

Ai uinteresua për këngën time që e donte shumë "Zot mbroje Kroacinë". Ai më pyeti se a do këndoja ende apo të shkoja në diplomaci, dhe gati kjo këngëu bë si himni i Kroacisë.

Meqenëse flas pesë gjuhë, anglisht, italisht në mënyrë aktive, unë përdor gjermanishten, rusishten dhe shqipen, Presidenti Tugjman, më sugjeroi që të filloj të shkojnë diplomaci. Kështu filloi karriera ime diplomatike, që zgjati gati një dekadë në Milano, në Romë, në Perth, Australi etj. Iliria: A keni dashur ndonjëherë të përfaqësoni Kroacinë në Kosovë, Shqipëri apo shqiptarët në Kroaci? Ju keni rrënjë shqiptare?

Gjani Marshan: Është një çështje shumë e ndjeshme në lidhje me Kosovën dhe Shqipërinë, rrënjët janë të njëjta, është një komb. Por, këto janë tani dy shtete.

Ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm, në lidhje me realitetin në botën politike. Unë di shumë për historinë, kulturën dhe jetën politike shqiptare.

Nuk ka dyshim se Kosova është një shtet sovran, i pavarur. Ne e dimë nga historia, se ky është një popull i prejardhur nga fiset ilire.

Ne po flasim për tre mijë vjet histori ose edhe më shumë, nga kohërat romake ku udhëhoqën edhe disa mbretër me Perandorinë Romake. romakë, të cilët ishin me origjinë ilire.

Kështu që ne kemi një ndjenjë, që gjithçka është e lidhur me emocionet.

Politika nuk njih emocione.

Edhe diplomacia. Prandaj, ekziston një mënyrë e të menduarit, e cila është e ndryshme dhe lidhet me të gjitha përpjekjet e mundshme globale, bota po globalizohet.

Ka pak vend për emocione, dhe ne si komb, jemi mjaft emocionalë.

Iliria: A mendoni se marrëdhëniet Kosovë, Serbi ndikojnë në njohjen e Kosovës nga Vatikani?

Gjani Marshan: Po, ne kemi prekur pikën më të ndjeshme, dhe kjo është marrëdhënia midis Republikës së Serbisë dhe Kosova. Gjëja më e rëndësishme është, që marrëdhëniet të normalizohen dhe, që të dy vendet të njohin njëri tjetrin.

Nëse një shqiptar, ka një mysafir në shtëpi, ai preferon të humbasë jetën sesa ta tradhtojë mysafirin. Ndihem shumë mirë, që i përkas atij kombi. Fatkeqësisht, në botën e sotme, vlerat tona janë prishur.

Iliria: A mendoni se shqiptarët kanë një avantazh si një popull ekumenik, me më shumë fe, apo ndoshta ky është një problem?

Gjani Marshan: Nëse i shohim Shqipërinë dhe Kosovën në përqindje, Islami është më dominues.

Ka rreth 15% ortodoksë dhe, rreth 10 derinë 12% katolikë. Është uniteti i krishterimit dhe Islamit. Kjo është mirë, nuk ka pasur kurrë konflikte fetare atje.

Rrënjët e mia janë nga një familje katolike e krishterë dhe mendoj se bashkëjetesa është e mundshme me myslimanë

dhe të tjerë, nuk më shkon ndërmend t'i ndaj. Kjo është diçka sublime për mua dhe kombin tonë.

Tomislav Ivçiq



Tomislav Ivçiq, vëllai i Gjani Marshanit, i lindur në Zarë, më 6 janar 1953 dhe, vdiq i ri në moshën 40 vjeçare, në një aksident trafiku në Zagreb me 4 mars 1993.

Ai ishte një këngëtar me renome, kompozitor dhe politikan kroat me origjinë arbëreshe.

Tomislav Ivçiq, pas mbarimit të shkollës së mesme në Zagreb bëri emër në estradën muzikore kroate dhe, tashmë si yll i muzikës, u regjistrua në studimet për ekonomi, në drejtimin e tregtisë së jashtme, por nuk i mbaroi studimet sepse më së shumti organizonte koncerte në qytete të ndryshme.

I lindur në Zarë, ai ishte një nga këngëtarët dhe kompozitorët më të famshëm kroatë të kohës së tij, falë paraqitjeve të shumta në festivalet e muzikës zbavitëse e popullore, në vitet 1970/80.

Gjatë karrierës së tij muzikore, ai u bë i njohur me hite të shumta, të frymëzuara kryesisht nga folklori dalmat, por edhe nga këngët e njohura italiane.

Në karrierën e tij të pasur si këngëtar dhe kompozitor, ai shkroi mbi 200 këngë dhe tekste dhe regjistroi 23 albume që u shitën 2.5 milionë kopje.

Ndër këngët më të njohura janë: Helmi nga buzët e tua, Kalelarga, kushtuar rrugëve e shëtitoreve të Zarës, hite kënga „Stop luftën në Kroaci,, në gjuhën angleze, dhe Sonte është festa jonë,, e cila u bë si himni i regjionit të Dalmacisë dhe, jehonte nëpër stadiumet e Kroacisë kur tifozët festonin fitoret e klubeve të tyre por këndohej edhe në ahengjet familjare.

Gjatë luftës në Kroaci, Ivçiq kompozoi dhe këndoi këngën hit "Stop the war in Croatia" në anglisht. Në shkurt të vitit 1993, si personalitet i pavarur, kandidoi për një mandat në Parlamentin kroat, të cilin e fitoi në zgjedhjedhe u bë deputet. Disa javë para se të merrte këtë pozitë, ai vdiq në një aksident trafiku në Zagreb në moshën 40 vjeçare në kombinacionin e famës së tij.

Vedran Ivçiq



Vedran Ivçiq, gjysmë vëllai i Gjani Marshanit, i lindur në Zarë, më 1951dhe, vdiq i ri në moshën 52 vjeçare më 2003, nga një sëmurje maligne. Ishte një këngëtar i njohur dhe kompozitor i talentuar.

Gjatë karrierës së tij regjistroi dhjetë albume, me vëllezërit e vet Tomislav Ivçiq dhe Gjani Marshan.

Në vitet e fundit të jetës së tij, ai publikoi katër albume, ndër to albumimë ishquar "Lotët e nënës sime".

Vedran Ivçiq, filloi të këndojë në fund të viteve '60 me grupe të ndryshme në sallat e vallëzimit të qytetit dhe tarracat verore të atëhershme. Regjistrimet e tij të para gramafoni datojnë në vitin 1972, kur ai regjistroi këngët "Berekin" dhe "Bakalar", kompozime që pëlqehen edhesot. Ai ishte një mysafir i mirëpritur në festivale dhe ngjarje të shumta, dhe veçanërisht i popullarizuar në mesin e mërgimtarëve kroatë në Australi e Amerikë.

Josip Pino Gjergja



Josip Gjergja, i lindur në Zarë, më 24 nëntor 1937, arbëresh, ishte një basketbollist profesionist dhe trajner kroat, reprezentues i ish-Jugosllavisë dhe, trajner i kombëtares kroate. Ai luante si mbrojtës aktiv, në vitet 1960 dhe 70. Gjergja ishte një nga lojtarët legjendarë, të Klubit basketbollit të Zarë.

Si lojtar, ai fitoi medaljen e argjendtë në Kampionatin botëror në 1963 në Brazil, e përsëriti atë katër vjet më vonë në Uruguvaj dhe, medaljen e argjendit në Kampionatin

Evropian në 1965 në BRSS. Prindërit e tij ishin babai Eugeni dhe nëna Ruzha.

Bashkëshortja e tij është Marija Shimoviq Gjergja, e cila me profesion ishte mësuese. Ai u arsimua në Shkollën e Lartë detare dhe Shkollën e lartë të Trajnimit.

Josip Gjergja



Josip Gjergja, u lind në Zarë, më 11 shkurt 1911 dhe vdiq më 18 shkurt 1990, në Beograd. Ky personalitet markant është arbëresh nga Arbanasi i Zarës, politikan dhe diplomat kroat.

Ka qenë anëtarë i Partisë Komuniste të Jugosllavisë nga viti 1934, i burgosur nga viti 1935-1938. Pjesëmarrës i

luftës antifashiste nga 1941. Pas Luftës së DytëBotërore ishte ambasador i Jugosllavisë në Shqipëri, Egjipt, Libi dhe Birmani. Ndihmës i ministrit për punë të jashtme të Jugosllavisë nga viti 1959-1963, deputet dhe Nënkryetarë i Kuvendit Federativ të Jugosllavisë (1970-1972).

Pasi ra në konflikt me udhëheqjen e Partisë komuniste dhe, politikën e Josip Broz Titos, dha dorëheqje.

Bozhidar Kalmeta



Bozhidar Kallmeta, i lindur më 15 janar 1958, në Zarë është një politikan i shquar kroat me prejardhje arbëreshe shqiptare. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në Zarë. Kalmeta në vitin 1982 diplomoi në Fakultetin e Agronomisë në Universitetin e Zagrebit. Pas diplomimit, në vitin 1983 është punësuar në Ndërmarrjen "Maraska" të Zarës, ku ka punuar si teknolog dhe shef i prodhimit deri

në vitin 1992. Ishte vullnetar në Luftën çlirimtare të Kroacisë dhe, ka luftuar në gjitha frontet për çlirimin e Kroacisë. Nga viti 1994 e deri në vitin 2003 në dy mandate ishte kryetar i suksesshëm i qytetit bregdetar të Zarës.

Nga viti 2003, ishte Ministër i detit, turizmit dhe transportit në Kroaci. Ishte edhe deputet i Parlamentit kroat.

Flet rrjedhshëm anglisht dhe italisht dhe çdo here me krenari e ka poetncuar kudo prejardhjen e tij arbëreshe.

Kruno Krstiq



Kruno Krstiq, leksikograf, gjuhëtar, filozof dhe psikolog kroat i lindur në Arbanas, në 1905 dhe vdiq në Zagreb, më 06. XII. 1987.

Shkollën fillore e kreu në Otok afër Sinjit. Shkollën e mesme e kreu në Sinj dhe, në vitin 1926, e kreu edhe gjimnazin klasik italian në Zarë.

Në Fakultetin Filozofik në Zagreb, ai u diplomua për filozofi, psikologji dhe gjuhë italiane, me letërsi në vitin 1930. Po ashtu diplomoi në frëngjisht dhe latinisht, në vitin 1934 dhe mbaroi doktoroi në fushën e psikologjisë në vitin 1937. Punoi si mësues në shkollën e mesme në Zagreb, Sisak dhe Osijek. Në vitin 1940, ai u bë inspektor i arsimit në Kroaci dhe më pas ishte ligjërues në Entin shtetëror të gjuhës kroate. Ishte redaktor i enciklopedisë kroate. Gjatë punës së tij në Institutin „Acta psikologici„ në Zagreb, ai dëshmoi se termi "psikologji" u përdor për herë të parë në shekullin 16-të dhe u përdor nga Marko Marulić, jo nga R. Göckel, O. Casmann, as P. Melanchthon, të cilëve u atribuohet. Ka pas publikime si dhe botime të botuara në psikologji, histori të psikologjisë, terminologji psikologjike dhe, filozofi. Është bashkautor i librit “Dallimet ndërmjet

Gjuhës letrare kroat edhe serbe”(me P.Guberin,1940) dhe, drejtshkrimi kroat bazuar në parime fonologjike (me P. Guberin dhe F. Cipro, 1941). Ka dhënë një kontribut të rëndësishëm, në Institutin Leksikografik si redaktor i profesioneve humaniste.

Si folës i mirë i dialektit arbëresh në Zarë dhe, gjuhëtar i shkëlqyer, botoi Fjalorin e dialektit arbëresh të Zarës (me një pasqyrë të fakteve historike dhe sociolinguistike me një përshkrim të veçorive themelore të të folurit. Në vitet 1980 ka botuar veprën për historinë e Arbëreshëve në Zarë dhe boton fjalorin arbëresh për çka mandej akuzohet nga qarqet sërbomadhe për nacionalist.

- Ka qenë poliglot dhe rrjedhshëm ka fol edhe shkruar: gjermanisht,
- anglisht,
- frëngjisht,
- latinisht,dhe

- italisht.

Vdes në Zagreb, në vitin 1987.

Augustin Stipčević



Augustin Stipceviq, u lind në Kotor të Malit Zi, më 28 korrik 1912, dhe vdiq në Zagreb, më 09 mars 1999. Ai ishte një shkrimtar, poet dhe intelektual i lartë arbëresh dhe, gati tërë jetën jetoi në Zagreb.

Është autor i Antologjisë proza e poezia e shqiptarëve të Jugosllavisë, në vitin 1970.

Ai ka lindur në Kotor, mandej familja e tij shpërngulet në Arbanas, ku kaloi pjesën më të madhe të fëmijërisë.

U shkollua në Zarë dhe Split, ku mbaroi shkollën e mesme. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik në Zagreb. Ishte personalitet me renome ndërkombëtare.

Punoi si redaktor në revistat Scena, Teatri, Republika etj. Ai ishte kryeredaktor i shtëpisë botuese “Agimi”-“Zora” dhe, nëpunës i lartë në Ministrinë e Arsimit.

Ai bashkëpunoi me revista prestigjioze shkencore, kulturore në Kroaci. Botoi me shume se 20 vepra në prozë, poezi dhe drama. Veprat e ti, janë përkthye në disa gjuhë botërore.

Ivica Mateshiq



Ivica Mateshiq Jeremija, u lind në Arbëresh afër Zarës, më 27shkurt1959, publicist, shkrimtar, oficer dhe përfaqësues ushtarako-diplomatik kroat.

Ka ushtruar një sërë funksionesh ushtarake dhe civile, si gjatë luftës atdhetare në Kroacie dhe pas saj.

Ai ishte luftëtar vullnetar në luftën e Kroacisë kundër ushtrisë Jugosllave dhe, tregoi trimëri edhe strategji

luftarake gjatë viteve 1990-1995, ishte zëvendës komandant i çetave në Arbanas dhe Riçinë, Kryetar i Kuvendit në Riçinë, Komandant i Batalionit të Togës sabotuese "Sveti Mihovil", ndihmës i komandantit të regjimentit të 7-të Kroacisë, ndihmës i komandantit të kuvendit në Zarë, profesornë shkollën e aviacionit "Rudolf Pereshin", në Zarë, këshilltar i qytetit, Kryetar i Bordit Turistik të qytetit të Zarës. Mateshiq është një kolumnist i rregullt në gazetatat e luftës dhe, raportues direkt nga frontet e luftës.

Pas luftës, ai ishte i dërguar, atashe ushtarak i Republikës së Kroacisë në Itali, 2005-2008. Ivica Gjovani Mateshiq-Jeremija, është autor i gjashtë veprave të botuara dhe fitues i shpërblimeve të shumta nga institucione të ndryshme, si dhe nga kryetari i Republikës së Kroacisë.


Që nga viti 2002 është anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kroacisë, vullnetar i luftës mbrojtëse të Kroacisë, koloneli Armatës Kroate, skenarist, pjesëmarrës në realizimin e disa

Filmave dokumentarë. Më 1994 si pas rezultateve të anketës së revistës "Narodni List" zgjidhet, Qytetar i Vitit në Zarë. Mbaroi magjistraturën në vitin 2009 në Fakultetin e Shkencave Politike dhe Gazetarisë në Universitetin e Perugjias. Poashtu ka magjistruar për komunikim në Zarë, në vitin 2010. Në vitin 2013, ishte shef i shërbimit për bashkëpunim ndërkombëtar të Ministrisë së Mbrojtjes. Disa mandate ishte i dërguari ushtarak, atashë i Republikës së Kroacisë në Maqedoni, Kosovë dhe Shqipëri, nga viti 2013 - 2017. Fituesi disa çmimeve ushtarake dhe civile . Ministri i Forcave të Sigurisë së Kosovës, Haki Demolli, më 20 tetor 2016, i ka ndarë medaljen atashëut të mbrojtjes së Kroacisë i akredituar në Kosovë Ivica Mateshiq. Medalja — Shërbimi i shquar i është ndarë atashëut kroat me motivacionin për kontributin e dhënë në forcimin dhe avancimin e bashkëpunimit në mes FSK-së dhe, Ministrisë së Mbrojtjes të Kroacisë, në prag të përfundimit të misionit të tij në Kosovë. Demolli e falënderoi kolonelin Mateshiq,

për kontributin e dhënë në forcimin e bashkëpunimit të dy ministrive, dy forcave si dhe, të dyja vendeve në fushën e sigurisë.

Në këtë eveniment, atasheu i Kroacisë, Ivica Mateshiq, duke falënderuar ministrin Demolli, në gjuhën arbëreshe dhe nën emocione shprehu krenarinë për prejardhjen e tij familjare, duke theksuar se rrjedh nga një familje arbëreshe, nga rrethinat e qytetit të Zarës, të Kroacisë.

Shime DUKA



Monsignor Simeone Duca nella sua casa romana con Madre Teresa di Calcutta

Shime Duka, ishte shkrimtar, arkivist dhe filantrop i lindur në Arbanas afër Zarës, me 7. IX. 1915. Shkollën e mesme kreu në Zarë, ndërsa studioi fakultetin e teologjisë në Zarë.

Ai ishte sekretar i kryepeshkopit të Zarës nga viti 1943 deri në 1946, dhe pas luftës së dytë botërore shkoi në Itali, ku studioi kanunin dhe të drejtën civile në Ateneo Lateranense, në Romë (1946–50) paleografi me diplomaci në Vatikan (1961– 64).

Doktoratën e mbrojtinë vitin 1950 në Romë, me disertacionin *La dottrina della guerra del cardinale Hostiensis proiettata sulla situazione odierna* (Doktrina e luftës e kardinalit Hostiensis e projektuar mbi situatën e sotme). Nga viti 1946 deri në vitin 1950, ishte Sekretar i Komisionit Papnor për Arkivat e Kishës në Itali dhe, nga viti 1963 e deri më 1973.

Sekretar i Shoqatës Ndërkombëtare të Arkivave të Kishës dhe Arkivit Sekret të Vatikanit.

Merrej me arkivat kishtare, me të drejtën kanonike dhe civile. Me paratë dhe pasurinë e tij, ai ndërtoi dhe rinovoi disa kisha në Kroaci, në Zarë, në Shqipëri dhe në Italinë Romë. Monsegnor Dr. Shime Duka, me origjinë nga

DAIM ILAZI-FIGURA MARKANTE TE ARBËRESHËT E ZARËS

Arbanasi i Zarës dhe, vdiq më 28 mars 2006, në shtëpinë e tij në Romë, në moshën 91-vjeçare dhe, 64 vite shërbeu si prift me autoritet të lartë.

Kryepeshkopi i Zarës, Ivan Prenda, në një deklaratë për media të enjten, më 30 mars 2006, theksoi kontributin e madh të të ndjerit duke e përshkruar atë si një njeri me arsim të madh dhe kulturë të gjerë. Shime Duka ka mbështetur ndërtimet e shumta të kishave të reja dhe rinovimin e atyre të rrënuara dhe të shkatërruara, ai u bënë dashamirës i madh i Kryedioqezës së Zarës.

Ai mbështeti qytetin e Zarës në fushën kulturore, i cili u shpërblye me çmimin për arritje jetësore në vitin 2000. Ai mbështeti Universitetin e Zarës në rinovimin e tij dhe në vitin 2002, iu dha titulli Doktor nderi, Doctor honoris causa, në Universitetin e rinovuar.

Do ta kujtojmë për veprat e tij të shumta, por edhe si njeri prift me jetë të thjeshtë e modeste, që meriton respekt të përhershëm, tha Kryepeshkopi Prenda. Si arbëresh me gjak

shqiptari ai bashkëpunonte dhe kishte takime me bashkë atdhetaren e tij, nobelisten Nënë Terezë, si dhe restauroi faltoren e Zojës së Këshillit të Mirë, në Shkodër.

Trupi i Dr.Shime Duka,u transferua nga Romanë Zarë dhe, u ekspozua në kishën famullitare të Zojës së Loretos në Arbanas. Varrimii të ndjerit është bërënë kishën e Zojës së Shëndetit në Zarë.

Dr. Ivo Peroviç



Ivo Peroviç, (1882-1958), ishte prefekti i madh i rajonit të Splitit. Ndhmësministri i Brendshëm i Mbretërisë së Jugosllavisë dhe, nga viti 1931,

Kryeshef i regjionit Sava Banovinës, të mëkëmbësit mbretëror të mbretit të mitur Petri II Karagjorgjeviç, nga 11 tetori 1934 gjer më 27 mars 1941. Dr. Peroviç ishte mason.

Dr. Peroviç, u lind në fshatin Arbanas afër Zarës në vitin 1882. Shkollën fillore dhe të mesme e kreu në Zarë. Ka studiuar drejtësi në Zarë, Pragë dhe Vjenë. Ai si student u shqua si aktivist dhe patriot i çështjes kombëtare, sidomos në Zarë dhe rrethinë, ku ai organizoi shoqatën “Skifterët,, dhe shoqëri të tjera arsimore.

Nga viti 1931, deri në vitin 1935, ishte Shef i banovinës së Savës. Pas vrasjes së mbretit Aleksandar Karagjorgjeviq në Marsej, Peroviç u emërua si një nga zëvendësit mbretëror prej tre personave në emër të mbretit të mitur Pjetri II, së bashku me princin Pavle Karagjorgjeviç dhe, Radenko Stankoviç.

Pushteti në thelb i takonte Pavlo Karagjorgjeviqit, pasi dy mëkëmbësit e tjerë ishin formalisht.

Pas Luftës së Dytë Botërore, Gjykata komuniste e Qarkut në Beograd në vitin 1949, si guvernator mbretëror për tradhti shtetërore, e dënoi me 11 vjet burg, ia hoqi të gjitha

të drejtat civile dhe sipas informacioneve të disponoheshë, ia konfiskoi pasurinë.

Ai dhe gruaja e tij kishin dy djem, njëri prej të cilëve vdiq në Zvicër, ndërsa tjetrinë SHBA. Mësojmë gjithashtu s esi Ivo Peroviq ka qenë i lidhur me Rjekën (ku edhe është varrosur), dhe ishte iniciator për ndërtimin e spitalit në Zagreb.

Ivan Prenda



Msgr. Ivan Prenda, u lind në Gornji Zemunik afër Zarës, më 31 dhjetor 1939 dhe, vdiq në Zagreb, 25 janar 2010. Ishtekryepeshkopii 68-tëi Zarës. U shuguruanë Zarë më 29 qershor 1964 dhe, u shugurua Ipeshk më 9 qershor 1990. Nga viti 1990, ishte kryepeshkop-bashkëdrejtuesi

Zarës me të drejtën e trashëgimisë dhe, Kryepeshkop i zakonshëm më 2 shkurt 1996.

Ka shërbyer si pastor në vitin 1964, në Shkabrnjë, Nadin dhe Smilçiq.

Prenda shërbeu si profesor i Studimeve Pastorale në Shkollën e Lartë

Teologjike në Zarë. Nga viti 1970 deri në vitin 1992, drejtor i Seminarit Arqipeshkëve—Zmajeviq.

Në vitin 1990 u bë kryepeshkopi i Zarës dhe zëvendës i përgjithshëm i kryepeshkopatës së Zarës.

Në vitin 1993, ai ishte bashkëthemelues i Shkollës së Lartë Teologjike dhe Katektike (së bashku me Imzot Marijan Oblak) në Zarë. Kryepeshkopi Prenda vdiq papritur në gjumë më 25 janar 2010 në Zagreb në moshën 71-vjeçare. Motoja e tij peshkopate ishte "Duaje Kishën". Në vitin 2010, ai mori një çmim pas vdekjes nga Qarku i Zarës për veprën e tij jetësore si restaurues shpirtëror dhe material i Kryedioqezës së Zarës. Kryepeshkopi Prenda u varros në

Katedralen e Zarës në prani të shumë delegacioneve kishtarë të Kroacisë dhe Vatikanit.

Ennio Stipçeviq



Ennio Stipçeviq, është muzikolog i madh dhe akademik kroat, anëtar i Akademisë shkencave e Arteve të Kroacisë, departamenti për historinë e muzikës kroate. Akademiku

Ennio Stipçeviq është djali i akademikut arbëresh, arkeologut, iliriologut të njohur Aleksandër Stipçeviq.

Ai është lindur në Zagreb, më 17 shtator 1959. Shkollën fillore e ndoqi në vendlindje, mbaroi shkollën e mesme, gjimnazin klasik në vitin 1978 dhe, studioi muzikologji në Akademinë e Muzikës në vitin 1983. Magjistraturën ekreu në lëndën Francesco Sponga–Usper dhe, mbrojti doktoratën me temën „Kultura muzikore në Kroaci gjatë shekullit të 17 në Fakultetin Filozofik në Zagreb në vitin 1993. Nga 15 qershori 1984, punësohet në Akademinë Kroate të Shkencave dhe Arteve (Departamenti i historisë së muzikës kroate).

U zgjodh bashkëpunëtor shkencorë në vitin 1994 dhe, bashkëpunëtor i lartë shkencor në vitin 2000 dhe, më pas këshilltar shkencor, në vitin 2010.

Qënga viti 1994 jep lëndë te muzikologjisë në Akademinë e muzikës në Zagreb (që nga viti 2008 si profesor i asociuar),ka dhënë mësim lëndën Studimet Kroate (1997-

2005), dhe në studimet e doktoratës, lëndën studimet mesjetare në Fakultetin Filozofisë në Zagreb (2007-2009).

Ka qënë drejtues i projekteve shkencore në Ministrinë Shkencës, Arsimit dhe Sportit të Republikës së Kroacisë. Në kuadër të Programit Ndërkombëtar të Kulturës (2007-2013), ai ishte drejtuesi i seksionit kroat të projektit shkencor francez-italiane-kroate-çek, *Aux Confins de l'Humanisme Musical – Monde Slave et Culture Méditerranéene* (që nga viti 2010), e cila u realizua në Centre d'Études Supérieures de la Renaissance, në Tours të Francës.

Ai qëndroi në udhëtime studimore në Venedik dhe Romë (1987), Graz (1992), Firence (1994), Paris (1995), dhe gjatë viti shkollor 1996/97, falë një burse nga Fondacioni Fulbright, ai kalon kohën e tij, si studiues vizitor në Universitetin Yale (New Haven) në SHBA.

Në qendër të punës së tij shkencore janë muzika kroate e Rilindjes dhe barok, kërkimi arkivor dhe paleografia muzikore .

Zbulimet e tij të librave të vjetër kroatë në bibliotekat italiane dhe kroate zgjuan interesin e publikut të gjerë shkencor dhe kulturor. Deri më tani ka botuar gjithsej 14 libra, 133 artikuj (53 shkencorë dhe 80 profesionalë), 20 botime kritike të muzikës, dhe rreth 300 artikuj gazetash, recensione, enciklopedi dhe shënime enciklopedi. Përveç kësaj, ai redaktoi 10 libra shkencorë. Mori pjesë në rreth tridhjetë takimee tribuna shkencore në Kroaci, Poloni, SHBA, Itali, Slloveni dhe Francë. Që nga viti 1992 është anëtar i Shoqatës Kroate Muzikologjie, që nga viti 1993 anëtar i Matica hrvatska, nga 28 tetor 2009, anëtar i Bordit të Bibliotekës së Akademisë së Shkencave të Kroacisë

Ai është fitues i çmimeve profesionale, Ivan Lukaçiq të Mbrëmjeve Barok të Varazhdinit (1988, 1998, 2011), Andrija Patricija Mbrëmjeve muzikore të Osorit (1998),

dhe çmime speciale, Çmimi për kontributin në Festivalin e Mbrëmjeve Baroke të Varazhdinit (1995) dhe Çmimi për kontributin në punën dhe përparimin e Liceut Klasik. Ai u nderua me çmime shkencore Josip Andreis të Shoqatës Kroate të Kompozitorëve për librin për I. Lukaçiqin (2008) dhe, çmimin e Akademisë Kroate të Shkencave dhe Arteve për librin për F. Usper (2009).

Që nga 12 maj 1994, ai është anëtar i Asociuar i Akademisë Kroate të Shkencave dhe Arteve.

Bernard Kotlar



Bernard Kotlar, është i lindur më 11.09.1956 në Arbanas të Zarës, është artist kroat. Bernard Kotlar, me profesion ishte inxhinier i elektronikës, me vite të tëra punoi si elektro projektues.

Bernardi merrej intensivisht me informatikë, fotografi, dizajngrafik, muzikë dhe sport. Është autor i dhjetëra CD-ve me përmbajtje të ndryshme, katër DVD-ve dhe producent i tri CD-ve me këngë. Për CD-në e parë multimediale—Zadarski Arbanasi/Arbëreshët e Zarës,,

2002 ka fituar Çmimin e qytetit Zarës për rezultate të arritura në kulturë. Në temën Arbanasët e Zarës, punoi DVD-në të quajtur "Štorija o zadarskim Arbanasima" (Storja për Arbëreshët e Zarë). Gjithsesi duhet të potencohet se Bernard Kotlar, me këtë punë kolosalei demantoi të gjitha dilemat rreth asaj se kush janë dhe, nga kanë ardhur banorët e Arbanasit të Zarës.

Kronisti Bernard Kotlar, në vitin 2016, prezantoi librin "Tregimi i pleqve tanë për traditat e arbëreshëvetë Zarës, në kuadër të kremtimit të 290 vjetorit të ardhjes së arbëreshëve në këto vise.

Përveç teksteve, libri përmban edhe 230 fotografi të vjetra, të zgjedhura nga Bernard Kotlar.

Dushko Modriniq



Dushko Modriniq, u lind në Zarë, në vitin 1979 dhe, është një aktor kroat i teatrit, televizionit dhe filmit. Ka luajtur role të ndryshme në shumë filma e seriale televizive në Kroaci. Ka diplomuar në akademinë e dramës dhe filmit, në Zagreb.

Aktori i ri Dushko Modriniq, çdoherë potencon dhe mburret se ai dhe dyvëllezërit e tij janë folësit më të rinjtë gjuhës arbëreshe, të cilën e përdorin rregullisht në shtëpi.

Origjinën arbanasee shoh si një thesar të dashur për mua. Kur takoj ndonjë burrë të moshuar në rrugë, flasim në arbërisht. Në të kaluarën njerëzit kishin turp t'i mësonin fëmijët e tyre arbanisht, që të mos talleshin fëmijët e tjerë. Modriniq, thekson se shumë nga bashkëbanorët e tij, janë këngëtarë të shkëlqyeshëm, shkencëtar dhe artist me famë evropiane.

Hrvoje Macanoviq



Hrvoje Macanoviq, është gazetar kroat i lindur në Arbanasi afër Zarës, më 1qershor 1904 dhe, vdiq në ujdhesën piktoreske në Mali Loshinj, më 4 janar 1980. Ka studiuar inxhinieri mekanike në Fakultetin teknik, në Zagreb.

Filloi të punojë si gazetar në vitin 1923, si korrespondent i Novo Dob-it, të Splitit.

Në vitin 1926, ai u bë gazetari i parë sportiv profesionist kroat në Novosti, ku më pas ishte redaktor dhe kryeredaktor, derisa gazeta pushoi së botimi në vitin 1941. Ai ishte i pari në Kroaci, që transmetoi një garë sportive drejtpërdrejt në radio - kampionatin e kanotazhit, në lumin Sava në Zagreb, më 1929, dhe ai ishte gjithashtu reporteri i parë kroat nga Lojërat Olimpikë (Amsterdam, 1928).

Ai ishte redaktor sportiv në gazetën “Minerva Lexikon”, gjatë vitit 1936.

Bashkëpunoi në organizatën ilegale Lëvizja Revolucionare Jugosllave e Kroatëve dhe, në vitin 1943 u arrestua si dhe u internua në kampin Mauthausen deri në përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1945.

Në vitet e para të pasluftës, mban poste të ndryshme (ushtrues detyre Rektor i Shkollës së Lartë i edukimit fizik në Zagreb, 1945–48 dhe, redaktor në disa gazeta sportive. Ai vazhdoi karrierën e tij gazetareske në Radio Zagreb dhe, Televizionin e Zagrebit. Macanoviq, ishte një nga

themeluesit dhe, redaktorët e Enciklopedisë së Kulturës Fizike, të Institutit Leksikografik Miroslav Krleža, në Zagreb.

Ratimir Kalmeta



Ratimir Kalmeta, ishte pedagog, mësues, gjeograf, shkrimtar dhe linguist i njohur kroat, me prejardhje shqiptare.

Ai ishte me prejardhje nga një familje arbëreshe, nga Zara. Ka botuar mbi 40 libra si dhe publikime shkencore në lëmi të gjeografisë dhe linguistikës.

Ratimir Kalmeta u lind më 22 qershor 1916 në Obrovac, një qytezë në brendësi të Zarës. Babai Petar ishte me origjinë nga Arbanasi afër Zarës (sot pjesë e atij qyteti), dhe nëna Katica (e lindur me mbiemrin Knez),nga rrethina e Kninit.

Babai i tij punonte si inspektor financiar, në të gjitha visete ish-Jugosllavinë. Ratimiri i si ri, ndoqi shkollat në katër qytete të ndryshme. Shkollën fillore e filloi në Split, kurse të mesmen e ndoqi në Plavë, të Malit të Zi.

Në vitin 1928, babai i tij vdiq në një spital, në Sarajevë, kështu që ai me familjen u shpërngul te daja i tij, në Shibenik, ku vazhdoi shkollën e mesme dhe, më pas, për shkak të regjistrimit të vëllezërve në studime, ai me familjen u shpërngulën përsëri në Zagreb, ku u diplomua në vitin 1941. Ai e kreu shërbimin ushtarak, dy vjet më

parë, në Boka. Gjatë shkollimit ka luajtur futboll në klubin amator —Jelaçiq nga Treshnjevka, ndërsa në kohën e lirë, luante edhe në violinë dhe, vizatonte filma vizatimorë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, u punësua në Ministrinë e Transportit, gjë, që i mundësoi financimin e studimeve të rregullta, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit, ku studioi gjeografinë (gjeografi), etnologji me etnografi si dhe historinë kroate. Ai u diplomua në të tre disiplinat antropogjeografike, të përmendura, më 9 mars 1946. Karrierën e tij si profesor, Kalmeta e filloi në vitin 1947, në gjimnazin e Nova Gradishkës, por në fund të po këtij viti, me ftesë të Josip Rogliqit, u kthye në Zagreb, ku punoi si asistent në Departamentin e Gjeografisë, të Fakultetit tëArteve. Pas tre vitesh, ai heq dorë nga karriera universitare dhe punësohet si profesor nëshkollën e mesme të Zagrebit e, më pas në vitin 1951, kaloi në Shkollën e Lartë Pedagogjike (sot Fakulteti iArsimtarëve), ku dha mësim lëndën e gjeografinë për dhjetë vjet.

Në vitin 1961, në bazë të konkursit publik, zgjidhet në detyrën e pedagogut të lartë në Fakultetin Ekonomik të sapo themeluar në Rjekë, ku përgatiti doktoratën me temën “Rijeka – funksioni i komunikacionit”, të cilën embrojti në vitin 1965, në Beograd. Pasi doktoron, punon në Rjekë, si profesor i asociuar për lëndët e gjeografisë ekonomike dhe turistike. Për një kohë të gjatë, ka qenë bashkëpunëtor i jashtëm i Institutit Ekonomik të Rjekës, dhe ka shërbyer edhe si këshilltar, në Fakultetin ekonomik.

Në vitin 1972, Ratimir Kalmeta, u detyrua të tërhiqej në moshën 56 vjeçare, çka shpjegohet me represionin e pushtetarëve, represionit që mbizotëroi pas pranverës së shtetit Kroat. Patriotizmi dhe lidhja e tij me identitetin kroat, janë evidente, që në rininë e tij të hershme, kur ai luajti për klubin nacionalist "Jelaçiq".

Deri në vitin 1970, angazhimi i Kalmetës për përdorimin e emrave kroatë nuk ishte i diskutueshëm, bëri bujë të madhe dhe redaktorët serbë të "Atlasit gjeografik" Jugosllav,

pranuan të gjithë sugjerimet, korrigjimin e tij për botimin latin dhe e venduan emrin e tij në kopertinë, duke e quajtur "bashkëpunëtor ekspert dhe korrektor për hapësirën gjuhësore kroate. Megjithatë, pas vitit 1972, dhe daljes në pension, për shkak të patriotizmit të theksuar kroat dhe të kërcënimit për arrestim nga regjimi serbo-jugosllav, iu desh të qëndronte jashtë vendit, për një kohë të shkurtë.

Nera Stipiçeviq



Nera Stipiçeviq, e lindur në Makarska, në vitin 1983, ku mbaroi shkollën fillore të muzikës, drejtimi piano.

Gjatë shkollës së mesme, ajo u morë me atletikë dhe, ishte anëtare e kombëtares kroate të kadetëve.

Ajo është këngëtare e njohur dhe artsiste filmi.

Në vitin 1993, ajo ishte finaliste në konkursin e këndimit Turbo Limaç, të Radio Televizionit Kroat. Ajo u bë e famshme duke marrë pjesë në shfaqjen Story SuperNova Music Talents, në fund të vitit 2003, ku përfundoi si një nga finalistët me sukses. Në vitin 2004, ajo publikoi albumin Nera.

Ajo u diplomua në Fakultetin Ekonomik në Zagreb, në vitin 2007, në drejtimin e marketingut turistik dhe, në vitin 2010, mori statusin e magjistër për aktrim në Akademinë e Arteve dramatike në Zagreb. Ajo luajti role tëndryshme edhe në film dhe, fitoi si finaliste në performansën Dancing with the Stars.

Bepo Mateshiq



Bepo Mateshiq, ishte këngëtar i madh kroat, me prejardhje arbëreshe.

I lindur në Zarë, në vitin 1945. Ai ishte kantautor dhe këngëtar m'i preferuar i Dalmacisë.

Vilson Xhoni



Vilson Xhoni, i lindur më 24 shtator 1950, në Split, ishte një ish-futbollist profesionist kroat, i cili ka luajtur si mbrojtës. Ai u shpall futbollisti m'i mirë i Jugosllavisë vitit 1978. Xhoni, ka lindur në Split, në një familje nga Prizreni dhe, është me prejardhje shqiptare nga Kosova.

Ai ishte një mbrojtës i shkëlqyer i Klubit futbollistik Hajduk, nga Spliti, arma më e madhe e të cilit ishte shpejtësia. Në nivel klubesh, ai kaloi dhjetë vjet në Hajduk të Splitit, duke luajtur gjithsej 207 ndeshje, në ligë.

Më pas u transferua te Dinamo e Zagrebit, ku kaloi vetëm një vit para se të transferohej te Schalke 04, në Gjermani. Xhoni, bëri debutimin etij për Jugosllavinë, në një ndeshje miqësore të shtatorit të vitit 1974, kundër Italisë. Më vonë punoi si skaut në Hajduk të Splitit, të Ligës së Parë Kroate, derisa u tërhoq, në vitin 2015.

Helena Bulaja



Helena Bulaja, është e lindur në Split të Kroacisë. Ajo u diplomua si historiane e artit dhe letërsi krahasuese, në Fakultetin filozofik, në Zagreb.

Jeton dhe vepron në Zagreb.

Bulaja, ka qenë aktive në artin digjital, dizajnim dhe film, që nga viti 1994. Në ditët e para të karrierës së saj ajo punoi si drejtoreshë artistike, dizajnere dhe ilustruese për disa revista kompjuterike kroate (Computerworld Croatia, Net, Vidi), dhe në vitin 1995, ajo filloi karrierën e saj artistike digjitale. Në vitet 1990, projektet e saj interaktive të artit, kryesisht të lidhura me metaforat, teleprezencën dhe lidhjen e botës reale me hapësirën kibernetike, u shfaqën në revista të tilla si Hotwired dhe, u prezantuan në përzgjedhjen Net Art, të Festivalit të Arteve dhe Teknologjisë - Ars Electronica, në Linz, Austri në vitin 1997.

Në vitin 2000, Bulaja, filloi një adaptim të animuar dhe interaktiv të përrallave, nga libri “Priče iz davnine”, (Përralla kroate të kohëve të shkuara), shkruar nga Ivana Brliq-Mazhuraniq, një shkrimtare kroate për fëmijë bazuar në mitologjinë sllave. Bulaja, ishte ideatore, kryeredaktore,

menaxhere, drejtoreshë dhe projektuese e projektit. Projekti u prezantua në më shumë se 30 konferenca dhe, festivale ndërkombëtare, kushtuar ekipeve të autorëve nga e gjithë bota (përfshirë Australinë, Gjermaninë, Francën, SHBA, Kanadanë, Anglinë dhe Skocinë), puna e të cilëve ishte e koordinuar në internet.

Nikola Spaniq



Nikola Spaniq, i lindur më 1633 dhe, vdiq më 1707, ishte një prelat katolik dhe fisnik i Korçulës (një ishull i bukur

Në Kroaci). Ishte pasardhës i familjes shqiptare spanjolle të Drivastos, i cili shërbeu si peshkop i ishullit, nga viti 1673 e, deri në 1707. Pas një tërmeti në 1667, ai restauroi një kishë kushtuar Shën Antonit, pranë qytetit kryesor të ishullit në Korçulë.

Valter Flego



Valter Flego, me prejardhje arbëreshe, i lindur më 15 gusht 1972, në Buzet, është një politikan kroat i cili ka qenë deputet i Parlamentit Evropian nga Kroacia, që nga 2

korriku 2019. Më parë, ai ka shërbyer si prefekt i katërt i Qarkut të Istrës, nga 2013 deri në 2019, si dhe shërbeu, tre mandate si kryetar i qytetit të Buzetit.

Shkollën fillore dhe dy vitet e para të shkollës së mesme i kreu në Buzet, ndërsa klasën e tretë dhe të katërt, në Rjekë. Pas mbarimit të shkollës së mesme, ai fitoi kualifikimin për teknik makinerie.

Në vitin 1991, regjistrohet në studimet për inxhinieri mekanike, në Universitetin e Rjekës, ku u diplomua në vitin 1996, me suksese të veçanta dhe, u bë inxhinier mekanik. Gjatë studimeve është nderuar me Çmimin e Rektorit të Universitetit të Rjekës, si studenti më i mirë i Fakultetit teknik.

Pas përfundimit të studimeve, Flego, u punësua në kompaninë Istrian Waterworks dhe, në të njëjtën kohë u regjistrua në studimet pasuniversitare në Fakultetin Ekonomik të Rjekës, të cilin i përfundoi në vitin 2000, duke marrë titullin master shkencor në ekonomi.

Pas zgjedhjeve vendore të vitit 2001, Flego, u bë kryetar i Bashkisë Buzet. Pas zgjedhjeve lokale të vitit 2005, ai u rizgjodh unanimisht kryetar bashkie nga këshilli i qytetit. Në zgjedhjet e para të drejtpërdrejta lokale, që u mbajtën në vitin 2009, Flego, mori mbi 84% të votuesve, duke arritur kështu rezultatin më të mirë, nga të gjithë kandidatët, për Kryetar komune, në Kroaci.

Flego është i martuar që nga viti 2002 me Branka Flego, mësuese e shkollës fillore. Ata kanë dy djem, Dinko dhe Ivo.

Gjin Gazulli



Gjin Kazulli, u lind në vitin 1440 në Raguzë.

Ishte intelektual dhe humanist i madh.

Pasi kreu studimet në vendlindje, në moshën 25 vjeçare shkoi në Padova ku u doktorua në Universitetin e Padovës.

Në një dokument të kohës thuhet: Johannes Gini Gazulo,

artium doctor, astronomus praeclarissimus|| (Gjon Gjin Gazulli, doktor i shkencave dhe astronom shumë i çmuar). Sipas historianëve dhe studiuesve të tij, ai qe edhe profesor i Universitetit të Padovës, ku sot ndodhet Fakulteti i juridikut.

Pa dyshim, ai ka qenë një ndër figurat më të shquara të shkencës evropiane të shekullit XV. Veprimtaria e tij shtrihet mes dy periudhave më të rëndësishme:

Humanizmit dhe Rilindjes Evropiane. Ai ishte astronom, matematikan, fizikan, filozof e diplomat, dhe padyshim mund t’i jepet atij, statusi i enciklopedistit për kohën kur jetoi dhe veproi.

Nga gjithë këto fusha, ato të dyja ku ai shkëlqeu më shumë janë astronomia dhe diplomacia.

Duke qenë se ka kaluar shumë kohë, që të mund të hidhet dritë mbi jetën dhe veprën e tij, është e domosdoshme të gjurmohen arkiva te Padovës, Budapestit, Venedikut e

Sidomos Raguzës, pra Dubrovniku i sotëm, vendi ku ai jetoi e punoi më gjatë.

Por edhe ndër arkivat private mund të gjenden material eqë kanë vlerë të madhe. Ndër to vlen të përmendim Arkivin e Fondeve Private Bassegli-Gozze.

Duke qenë se Gazulli ushtroi veprimtarinë e tij, si në Itali e në Raguzë, ashtu edhe në shumë vende të tjera evropiane, ku e çoi detyra e tij diplomatike e shkencore, të dhëna të vlefshme i jep edhe literatura e kohës, mbi këtë enciklopedist me origjinë shqiptare. Studiuesit italianë, janë të bindur se ai ka origjinë italiane. Studiuesit kroatë, sipas tyre, japin fakte të pakontestueshme se Gjon Gazulli ishte kroat, arbëresh nga Raguza.

Ndërsa studiuesit shqiptarë e shpjegojnë prejardhjen e tij shqiptare, nisur nga mbiemri, të cilin e lidhin me një fshat në një ndër krahinat e Shqipërisë së Veriut. Sipas tyre, ai mund ta ketë prejardhjen nga Mirdita.

Gjon Gazulli, mbylli sytë përfundimisht në Raguzë, më 19 shkurt 1465 dhe, la pas një emër dhe një vepër të shquar, e cila vlen edhe sot, për studime në fushat e astronomisë e diplomacisë.

Fjala e recenzentit

Libri më i ri i autorit Daim ILAZI, i titulluar “Figura markante të arbëreshëve të Zarës”, ofron të dhëna të përmbledhura bibliografike për figura të njohura kroate me prejardhje shqiptare-arbëreshe, si:

- shkrimtarë,
- muzikantë,
- akademikë,
- shkencëtar,
- artist,
- gazetar,dhe
- sportist të njohur, që kanë fituar çmime prestigjioze në Kroaci e jashtë saj.

Në këtë libër, jepen të dhëna interesante të përmbledhura për jetën dhe krijimtarinë tyre, që i mundësojnë lexuesit, që të përfitojë dije mbi tërë aktivitetet dhe opusin e veprave të tyre .Libri është botim specifik dhe i përshtatur

për të gjithë lexuesit, që duan t'i zgjerojnë njohuritë e tyre për disa personalitete arbëreshe të Zarës, që kanë arritur në maje të piramidës, me sukseset e tyre në fusha tëndryshme. Me këto personalitete krenohet Kroacia, por edhe shqiptarët sepse ato çdo herë e kanë potencuar se kanë rrënjë shqiptare, pra flasin gjuhën e tyre arbëreshe nëpër shtëpitë e tyre. Kylibër, që është shkruar me gjuhë të qartë, është i vlefshëm për një kulturë të përgjithshme për nxënës dhe studentë ose një mase lexuesish të gjitha kategorive. Lexuesit, duke e lexuar këtë libër, arrijnë t'i zgjerojnë njohuritë e tyre për jetën, kulturën e gjuhën si dhe traditat dhe, në veçanti te arbëreshët e Zarës. Autori Daim ILAZI, ka arritur që në vija të shkurtra të prezantojë para lexuesit, jo vetëm gjërat më domethënëse të opusit krijues të këtyre si: intelektualëve, artistëve, muzikantëve me përmasa ndërkombëtare. të dhëna interesante për jetën private të tyre, intervista të ndryshme nga ata. Ky libër është i dobishëm nga se është shkruar me përkushtim dhe

kompetencë, është ide shumë e qëlluar. Është libër i preferuar për historinë, fatin e arbëreshëve dhe kulturën shqiptare në përgjithësi. Autori na bën ftesë ta njohim madhështinë e arbëreshëve të Zarës, që thuajse janë asimiluar, por me krenari e ruajnë traditën shqiptare në Kroaci. Në libër, flitet për sukseset, për vështirësitë që ata kanë pasur derisa kanë arritur ta fitojnë famën në Kroaci e disa nga ata figura me përmasa botërore dhe gjithë kohorë. Këto personalitete me altruizmin, profesionalizmin, humanizmin dhe, bujarinë e tyre, janë integruar plotësisht në shtetin e Kroacisë dhe, paraqesin vlerë të shtuar, kanë lënë gjurmë të pashlyera dhe kanë pushtuar zemrat e shumë njerëzve në Kroaci e në botë.

Prof.dr,EjupAjdini

Biografia



Daim ILAZI, u lind më 6.01.1954 në fshatin Zhelinë-Tetovë, ku përfundoi shkollën fillore në fshatin e lindjes, gjimnazin me sukses të shkëlqyer e kreunë Tetovë, Republika e Maqedonisë Veriut dhe, u diplomua në Universitetin e Zagrebit, Kroaci - Arkeologji dhe gjuhë frënge, në 1979.

D. ILAZI punoi si profesor i gjuhës frenge e latine, në shkollën e mesme medicinalenë Tetovë, për më shumë se dy dekada. Ai ka punuar si diplomat i lartë i karrierës për një kohë të gjatë 22 vjeçare, në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Punoi si Konsull në Ambasadën e Republikës Maqedonisë së Veriut në Bernë-Zvicër (1995-1999) dhe, Këshilltar në Ambasadën e Republikës së Maqedonisë Veriut në Paris (2002-2006),

Ministër-Këshilltar në Ambasadën e Republikës së Maqedonisë Veriut (2011-2013), në Bruksel dhe Ministër Këshilltar, në Ambasadën e Maqedonisë Veriut në kryeqytetin turk Ankara.

Ai ka punuar si udhëheqës, kryeshef, në Ministrinë e Punëve të Jashtme në sektorë të ndryshëm. Eshtë dekorua nga Qeveria e Francës me medaljen "Kalorësi i Palmës Akademike". Ai ishte anëtar i Bordit të Mbrëmjeve të Poezisë në Strugë, festivalit më të madh ndërkombëtar të poezisë në Maqedoninë e Veriut. Me propozimin dhe

inistimin eti ju aprovu që Fatos Arapi nga Shqipëria të jetë laureat i Kurorës së artë që u pranua nga Bordi i kryesisë së Mbëmjeve poetike të Strugës.

Daim ILAZI ka fituar çmimin për poezi Euro-Frankofone në Paris, në 2006 dhe gjatë viteve 1992-94, ai ishte President dhe themelues i Klubit Kulturor Francez në Tetovë.

Ka marrë pjesë në shumë festivale poetike në vendin tonë dhe jashtë. Ai është nga themeluesit dhe nënkryetar i Shoqatës së shkrimtarëve OENEUM në Tetovë. Aibotoi 7 libra me poezi dhe një libër publicistik në shqip, një liber poezinë frëngjisht-shqip "Marrëzi ballkanike- Folie Balkanique" dhe një në përkthim maqedonisht „ Bie shinë Tetovë- Vo Tetovo vrne dozhd".

Libri „Nobelistët botërorë të letërsisë,, është libri i shtat.. Kete vit boto ilibrin e tetë me poezi, shqip maqedonisht : Lundrim në kohë/Vremeplov . Flet dhe shkruan disa gjuhë botërore. Është i martuar dhe ka tre fëmijë.

Tani është Kryetar i Shoqatës së shkrimtarëve
“OENEUM”, në Tetovë. Jeton në Tetovë.

Bibliografi dhe referenca:

1. Dr. prof. Aleksandar Stipçeviq:
Shqiptarët për arbëreshët e Zarës
2. Dr. prof. Lucija Shimishiq: Etnojezicni vitalitet Arbanasa
3. Hrvatski biografski leksikon
4. Dr. prof. Sergjo Dokaz: Povijest i kultura Zadarskih
Arbanasa
5. Arbanasi, Hrvatska enciklopedija
6. Dr. prof. Mirta Toma: Arbanaski govor

DAIM ILAZI-FIGURA MARKANTE TE ARBËRESHËT E ZARËS

PËRMBAJTJA:

Në vend të hyrjes	3
Figura te ndritura të Zarës	6
Aleksandar Stipçeviq	21
Valter Deshpali	28
Shime Deshpali.....	32
Maja (Marija) Deshpali Begoviq.....	36
Pavle Deshpali	39
Josip Rela	44
Gjani Marshan	47
Tomislav Ivçiq	57
Vedran Ivçiq.....	60
Josip Pino Gjergja	62
Josip Gjergja.....	64
Bozhidar Kalmeta.....	66
Kruno Krstiq.....	68
Augustin Stipčević	71
Ivica Mateshiq	73
Shime DUKA	77
Dr. Ivo Peroviç	81
Ivan Prenda.....	84
Ennio Stipçeviq	86
Bernard Kotlar	91
Dushko Modriniq	93
Hrvoje Macanoviq.....	95
Ratimir Kalmeta	97

DAIM ILAZI-FIGURA MARKANTE TE ARBËRESHËT E ZARËS

Nera Stipiçeviq	102
Bepo Mateshiq.....	104
Vilson Xhoni.....	105
Helena Bulaja	106
Nikola Spaniq	108
Valter Flego	109
Gjin Gazulli	112
Fjala e recenzentit	116
Biografia	119



ISBN 978-608-66366-4-7